



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 224/11 Prot.

Tiranë, më 07 . 07 . 2025

V E N D I M

Nr. 160, datë 07 . 07 . 2025

Bazuar në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 24, datë 04.02.2025, e paraqitur nga z. S.F kundër Shoqërisë që ofron shërbimin në linjën e transportit Tiranë-Bërzhitë-Pëllumbas, me pretendimin për diskriminim, për shkak të “aftësisë së kufizuar¹”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, në parashtrimet e depozituara pranë KMD-së, ndër të tjera, citon se: “Me datë 28.01.2025, po udhëtoja nga Tirana për në Pëllumbas bashkë me bashkëshorten time e cila edhe ajo është invalide pune. Hipëm në autobusin e linjës Tiranë-Bërzhitë-Pëllumbas me targa AA 049 SV, në orën 7:40 të mëngjesit, tek stacioni pranë ekonomikut. Autobusi kishte faturinon dhe kur erdhi koha për të prerë biletat, ne sipas ligjit i paraqitëm librezat. Faturino na tha që në këtë linjë nuk njihen librezat dhe shpjegoi që asnjëherë nuk kemi pranuar që personat me aftësi të kufizuar të udhëtojnë me librezë në këtë linjë. Megjithatë faturino na tha që në autobus është pronari, flisni me ta, në momentin që faturino lajmëroi pronarin ai ndaloi autobusin dhe në mënyrë të dhunshme kërkoj të zbriste në tokë, por ne këmbëngulëm duke i thënë më jep biletat dhe do të paguajmë. Ai përsëri në mënyrë të dhunshme u përgjigj, shpejt në tokë, mjeti është i imi personal, unë kam dalë me mbledhë lekë e jo invalid. Nxorëm lekët dhe i dhamë, shuma që kërkoi ishte 100 lekë për person, ndërsa biletat që na dha kishin vlerën 40 lekë për person. Me këtë veprim sipas nesh ai vjedh

¹ Referuar Librezës së Verbërisë nr. 25980, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

drejtpërdrejt qytetarët, duke marr një shumë më të lartë se bileta e caktuar nga bashkia, ndërsa personat me aftësi të kufizuar nuk e përfitojnë këtë shërbim sipas ligjit ashtu siç na ndodhi në këtë linjë”.

Në përfundim ankuesi, kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe eliminimin e pasojave për shkak të tij.

II. Procedurat e ndjekura nga Komisioneri

Pas kryerjes së verifikimit paraprak të ankesës dha akteve bashkëlidhur saj, KMD gjykoi se ankesa duhej plotësuar me informacion plotësues. Për këtë arsye, Komisioneri veproi, si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 224/2, datë 17.02.2025, iu drejtua Bashkisë Tiranë, në të cilën kërkoi informacion për identifikimin e kompanive të licencuara në linjën e transportit të udhëtarëve Tiranë-Bërzhitë-Pëllumbas dhe anasjelltas.
2. Me shkresën nr. 1639/1, datë 04.03.2025, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit e Bashkisë Tiranë, ka vënë në dijeni Komisionerin, se informacioni i kërkuar i është deleguar për kompetencë Drejtorisë së Transportit dhe Trafikut Rrugor.
3. Me shkresën nr. 224/3, datë 26.03.2025, Komisioneri ka bërë kujtesë institucioneve të Bashkisë Tiranë, për shkresën nr. 224/2, datë 26.03.2025.
4. Me shkresën nr. 2526/1, datë 04.04.2025, Agjencia e Mbrojtjes së Konsumatorit e Bashkisë Tiranë, ka vënë në dijeni Komisionerin, se informacioni dhe dokumentacioni në lidhje me ankesën e z. F, kalonte përtej mundësive administrative për dhënien e tyre, dhe e kanë deleguar për kompetencë Drejtorisë së Transportit dhe Trafikut Rrugor.
5. Komisioneri me shkresën nr. 224/5, datë 16.04.2025, iu drejtua DPSHTRR, në të cilën kërkoi informacion për identifikimin e kompanive të licencuara në linjën e transportit të udhëtarëve Tiranë-Bërzhitë-Pëllumbas dhe anasjelltas.
6. Me shkresën nr. 10359/1, datë 22.04.2025, Drejtoria e Transportit e Trafikut Rrugor, informoi Komisionerin se: *“Sipas ligjit në fuqi nr. 7889, datë 14.12.1994, për “Statusin e invalidit të punës”, i ndryshuar, neni 11/1, specifikon se: “Udhëtimi i invalidëve me mjetet e komunikacionit shtetëror dhe privat qytetas bëhet falas”.* Aktualisht sipas legjislacionit në fuqi nuk parashikohet lehtësim në udhëtimin rrethqytetas për kategorinë e invalidëve të punës.
7. Me shkresën nr. 7793/1, datë 23.04.2025, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përcolli informacionin duke sqaruar ndër të tjera se: *“Linja e transportit të udhëtarëve Tiranë-Bërzhitë-Tiranë është linjë rrethqytetase dhe nuk është pjesë e linjave të miratuara me Udhëzimin nr. 5628, datë 18.11.2016 “Për miratimin e rregjësive të linjave ndërqytetase”, i ndryshuar, përkatësisht lëshimi i licencës/certifikatave për operim në këtë linjë nuk kryhet nga DPSHTRR, por nga Bashkia Tiranë. Për sa i përket kërkesës për informacion për mjetin me targë AA049SV, nga verifikimi në sistemin elektronik e-DPSHTRR, rezulton në pronësi të subjektit “Klindi” sh.p.k, me NIPT K61309001L”.*

8. Pas identifikimit të subjektit që ofron shërbimin në linjën e transportit Tiranë-Bërzhitë-Pëllumbas, kundër të cilit është paraqitur ankesa, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr. 224/8, datë 28.04.2025, ka kërkuar nga z. F, si më poshtë:
Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ju deklaroni se, gjatë udhëtimit tuaj në datë 28.01.2025, i keni paraqitur faturinos librezën, por pa specifikuar se për cilën librezë bëhet fjalë. Sa më sipër, kërkohet nga ana juaj të informoni Komisionerin se, cila librezë është paraqitur nga ana juaj, librezë e lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror apo librezë e lëshuar nga ana e Shoqatës Shpresë për të Verbërit?
9. Me shkresën nr. 224/9, datë 21.05.2025, Komisioneri ka kërkuar përsëri nga z. F, informacionin e kërkuar me shkresën nr. 224/8, datë 28.04.2025.

Referuar dokumenteve: Lajmërim Marrje poste, nr. RR763327621AA dhe RR781972643AA, rezulton se z. F ka marrë dijeni për shkresat e sipërcituara, por nuk ka kthyer përgjigje.

III. Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur nënenin 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për një listë joshteruese shkaqesh. Në këtë nen parashikohet shprehimisht se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohej ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në Kreun IV, të ligjit të sipërcituar parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pika 1, germa a) parashikon shprehimisht se: *“Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji...”*

Në bazë të dispozitave të LMD, të ndryshuar, ankesat e depozituara pranë KMD-së shqyrtohen nga ky institucion dhe në përfundim të procedurave hetimore Komisioneri shprehet me vendimmarrje, nëpërmjet së cilës kryesisht konstaton ose jo diskriminimin e pretenduar për një ose disa nga shkaqet e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, shkronja “ç” të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse:ç) është haptazi e pabazuar...;”, Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet pasi është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, bazuar në arsyetimin vijues:

Në ankesën e depozituar nga ana e z. S.F, pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar/i verbër nga ana e Shoqërisë së transportit të linjës Tiranë-Bërzhitë-Tiranë, përmes mosnjohjes së të drejtës për të udhëtuar me 50% të çmimit të biletës në linjën e transportit rrethqytetas, ndërkohë që një gjë e tillë është e parashikuar në legjislacionin përkatës.

Lidhur me dispozitat ligjore që normojnë të drejtën e udhëtimit në transportin rrethqytetas të kategorisë së personave me aftësi të kufizuar/të verbër, me biletë me gjysmë çmimi, citojmë si vijon:

Mbështetur në legjislacionin në fuqi³ që rregullon fushën e transportit, transporti rrugor i udhëtarëve brenda vendit në formën e shërbimit të linjave të rregullta, ndahet në: (1) transport qytetas, (2) transport rrethqytetas dhe (3) transport ndërqytetas. Transporti rrethqytetas që përbën objektin e kësaj anekese, bën pjesë në kompetencat e pushtetit vendor. Ndërkohë që, transporti ndërqytetas rregullohet nga ministri përgjegjës për veprimtarinë e transportit. Kjo ndarje e kompetencave sipas llojeve të transportit, ngarkon me përgjegjësi pushtetin qendror dhe atë vendor.

Me qëllim identifikimin e bazës ligjore që përmban parashikime pozitive, lidhur me përfitim të transportit falas për kategorinë e personave të verbër, Komisioneri, mori në analizim ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit” (Ndryshuar me ligjin nr. 26/2012, datë 15.03.2012).

Referuar dispozitave të ligjit të sipërpërmendur, rezultoi se, fillimisht neni 11, i këtij ligji parashikonte shprehimisht: “*Të verbërit kanë të drejtë që ata vetë dhe shoqëruesit e tyre të udhëtojnë falas në transportin urban, dhe me gjysmë çmimi në transportin interurban, duke përfshirë atë shtetëror dhe privat*”.

³ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar) dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

Në vijim, neni 11, i ligjit të sipërpërmendur është ndryshuar, nëpërmjet ligjit nr. 26/2012, datë 15.03.2012 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”. Aktualisht, ky nen parashikon: “Të verbrit dhe shoqëruesit e tyre përfitojnë kompensim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Sikurse vihet re nga sa më sipër, pas ndryshimeve, që i janë bërë në vitin 2012, ligjit nr. 8098/1996 “Për Statusin e të Verbërit” (i ndryshuar), personat e verbër nuk përfitojnë më transport qytetas/urban⁴ falas dhe transport interurban⁵/ndërqytetas me 50% të vlerës së biletës. Me ndryshimet ligjore, kjo kategori do të përfitojë kompensim për shërbimin e transportit. Masa, kriteret dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, i cili nuk është miratuar ende.

Në vendimmarrjet e mëparshme të KMD-së⁶ lidhur me mungesën e daljes së këtij akti rregullator nënligjor/VKM, Komisioneri, ka rekomanduar që:

- Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 85, të Ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar.
- Këshilli i Ministrave të marrë masa, për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar.
- Këshilli i Ministrave të marrë masa për ndryshimet në legjislacion dhe në aktet nënligjore, sipas nenit 20, të Ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”.

Komisioneri, vëren se, në parim, pavarësisht këtij vakumi ligjor, Kompanitë duhet të njohin dhe zbatojnë detyrimin e përcaktuar edhe në aktet e tjera rregullatore që lidhen specifikisht me të drejtën e ushtrimit të shërbimeve që ofrohen nga këto Kompani, si dhe Licencën për kryerjen e shërbimeve të rregullta ndërqytetëse të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit.

Nga ana tjetër, ankuesi kishte kontestime lidhur me faktin që shërbimi nuk i është ofruar konform lehtësirave të parashikuara për personat me status të verbëri nga ana e Kompanisë, por nuk ka specifikuar se cilën librezë të verbërisë ka paraqitur.

Legjislacioni i miratuar në fushën e transportit përmban parashikime të përgjithshme mbi lehtësitë, që duhet të përfitojnë në shërbimin e transportit urban rrethqytetas, për shtresat dhe kategoritë vulnerabël, por gjithmonë duke kryer referencën përkatëse, në ligjet e posaçme për secilën kategori.

Udhëzimi nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, “Mbi modelet dhe standardet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”, bën një identifikim të grupeve, që

⁴ Terminologji e përdorur në këto ligje;

⁵ Terminologji e përdorur në këto ligje;

⁶ Vendimi nr. 67, datë 10.06.2019; Vendimi nr. 146, datë 06.08.2021; Vendimi nr. 174, datë 20.09.2021, i KMD-së, etj.

përfitojnë lehtësira financiare në marrjen e shërbimeve publike në përputhje me kuadrin ligjor, por jo llojin e lehtësirave që përfitojnë.

Personat që u përkasin kategorive apo grupeve në fjalë, pajisen me *Kartat standarde të personalizuar*. Në pikën 5.3.2.1, 5.3.2.2 dhe 5.3.2.4 përcaktohen si të tillë: invalidët e punës, të verbërit dhe invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Në pikën 5.3.2.6, të Udhëzimit nr. 3743/2017, parashikohet si përfitues edhe çdo subjekt ose kategori që mund të përfitojë në vijim, mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Për sa më sipër, rezulton se personat me aftësi të kufizuara që gëzojnë statusin e të verbërit gëzojnë lehtësira në shërbimin e transportit, duke përfshirë këtu të tre format e transportit me linja të rregullta, pra transport qytetas, rrethqytetas dhe ndërqytetas.

Lidhur me lehtësirat dhe të drejtën e personave me statusin e të verbërit, për të udhëtuar në transportin urban ndërqytetas, neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “*Për transportet rrugore*” (i ndryshuar)⁷ parashikon se: “*Është e detyrueshme të kryhet përkujdesja dhe transporti me përparësi, kundrejt të gjitha lehtësive që jep ligji, për të gjitha subjektet që i përfitojnë këto lehtësi në transportin qytetës dhe jashtë qytetit, duke përcaktuar me shënim të veçantë edhe vendet e ndenjes për ta.*”

Udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta, duhet të paraqesin në çdo rast udhëtimi dokumentin që përcakton ligji për ta.

Bazuar në sa më sipër, ligji ua njeh këtë të drejtë të gjithë personave me statusin e të verbërit, konform detyrimit për të paraqitur në çdo rast udhëtimi dokumentin ligjor specifik.

Në këtë kontekst, Komisioneri ka analizuar se cilat shkresa konsiderohen *dokument ligjor*, sipas përcaktimeve ligjore përkatëse.

VKM nr. 277, datë 18.06.1997 “*Për përfitimet nga statusi i të verbërit*”, i ndryshuar, në pikën 3 dhe 10, të tij ka parashikuar se: “3. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror i lëshon personit të verbër librezën e verbërisë, si dokument prove për përfitimin nga ligji nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", pas marrjes së vendimit nga Komisioni Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë. Modeli i librezës së verbërisë përcaktohet nga Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta......

⁷ Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “*Për transportet rrugore*” (i ndryshuar me ligjin nr. 10/2016, “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore"*”, ligjin nr. 37/2014 “*Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore"*”, ligjin nr. 21/2013, “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore"*”, ligjin nr. 10/302, datë 15.07.2010 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore"*”, ligjin nr. 9760, datë 21.06.2007 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore"*”, ligjin nr. 9373, datë 14.04.2005, “*Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore"*”, ligjin nr. 9096, datë 03.07.2003, “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore"*”, ndryshuar me ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002”, ligjin nr. 8908, datë 06.06.2002 “*Për disa ndryshime në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore"*”).

10. Udhëtimi në transportin e brendshëm shtetëror dhe privat për personat e verbër behet me 0% të tarifave për transportin urban dhe 50% të tarifave për transportin interurban. Këtë tarifë e përfiton edhe shoqëruesi i të verbrit të grupit të parë”.

Ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në kreun VIII “Shkresat” ka përcaktuar respektivisht si më poshtë citohet:

Neni 246 “Fuqia provuese e shkresave” ka parashikuar se: “Shkresat kanë fuqi provuese kur janë hartuar në formën e caktuar, kanë elementet e nevojshme për vlerën e tyre, nuk janë të copëtuara, të grisura ose të shuara, nuk kanë gërvishnje, ose shtesa midis rreshtave, ose çrregullime të tjera me shuarje dhe mund të lexohen”.

Neni 251 “Kopja e shkresës dhe origjinale i saj”, i tij, ka parashikuar se: “Kopjet e shkresave kur saktësia e tyre vërtetohet nga personi kompetent kanë të njëjtën fuqi provuese me origjinalin”.

Ligji nr. 110/2018 “Për noterinë”, në nenin 3/c) të tij, ka përcaktuar se: “Noter” është personi fizik i licencuar nga ministri i Drejtësisë për kryerjen e veprimtarisë noteriale brenda territorit të një bashkie të caktuar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji”.

Në Kreun V të këtij ligji, janë përcaktuar kompetencat, të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrat e noterit. Kështu, neni 62, pika 1/i, e tij ka parashikuar se: “Noteri, përveç kompetencave të parashikuara në ligje të veçanta, harton akte, kryen njësimë, vërtetime dhe verifikime në të gjitha çështjet, duke përfshirë, por pa u kufizuar:

vërteton se kopjet ose versionet e shkurtuara të dokumenteve janë të njëjta me origjinalin e paraqitur nga palët e interesuara”.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ligji ka mirëpërcaktuar se cilat shkresa konsiderohen si dokument ligjor, mënyrën e hartimit apo njësimit të tyre si dhe autoritetin përgjegjës i cili gëzon ligjërisht këto kompetenca. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues për të përfituar nga lehtësirat në udhëtim në linjat e transportit rrethqytetas duhet të tregojë dokumentin ligjor përkatës, Librezën e Verbërisë, të lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror.

Referuar vendimeve të mëparshme të Komisionerit, z. S.F ka deklaruar⁸ se në të gjitha udhëtimet e linjave të ndryshme të transportit rrugor, paraqet librezën e lëshuar nga Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, pasi në gjykimin e tij ka të njëjtën fuqi ligjore dhe duhet të përfitojë dhe gëzojë të njëjtat lehtësira ligjore. Në vlerësim të sa më sipër, rezulton se ankuesi është i paqartë në deklarimin e tij, lidhur me librezën që ka paraqitur gjatë udhëtimit.

Në analizë të sa më sipër, Komisioneri gjykon se ankuesi, sa kohë nuk ka përmbushur detyrimin e tij për të paraqitur para faturinos, dokumentin e përcaktuar ligjor (Librezën e Verbërisë, të lëshuar

⁸ Referuar deklarimeve në seancat: datë 22.08.2024, në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr. 111, datë 22.05.2024, seancës dëgjimore datë 18.12.2024, në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr. 152, datë 22.07.2024 dhe seancës datë 19.12.2024, në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr. 168, datë 22.08.2024.

nga Shërbimi Social Shtetëror, ose kopjen e noterizuar të saj); nuk ka arritur të provojë para KMD-së, se pretendimi i tij, se është ekspozuar ndaj një qëndrimi të pabarabartë e të pafavorshëm, nga ana e Shoqërisë së transportit të linjës Tiranë-Bërzhitë-Tiranë, qëndron dhe është i bazuar.

Në mungesë të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, ankesa e z. S.F, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁹.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 7, pika 3, nenin 20, pika 1 , shkronja “a”, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a), nenin 33, pika 4, shkronja “ç” të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 24, datë 04.02.2025, të z. S.F, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

⁹ Për analogji citojmë Vendimet nr. 177, datë 04.06.2024, nr. 246, datë 23.09.2024 dhe nr. 33, datë 11.02.2025, të KMD-së.